



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|---------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Doretuar Pimljena / Prodato Received / Delivery | 10-08-2022 | viti god year | |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr. Prot Br. Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIP/Pran | 4644/2022 | | 1/3 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.580/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.580/2022 të datës 29.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi lagja fshati _____ undër organit të punësimit/Komuna e Shtërpcës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.580/2022 e datës 29.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ ka aplikuar në konkursin e datës 01.03.2022 sipas njoftimit të datës 14.02.2022 me nr.02-111/01-1696/22 me nr.RN00008604 për pozitën Inspektor i shërbimeve publike në Komunën e Shtërpcës i cili i është nënshtruar procedurave të rekrutimit, testit me shkrim dhe intervistës me gojë. Me datën 25.05.2022 Komuna e Shtërpcës kanë shpallur njoftimin për kandidatin e përzgjedhur.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 25.05.2022 me nr.02-030/01-6600/22 me datën 01.06.2022 ka parashtruar ankesë për Komisionin e Pranimit. Me datën 02.06.2022 Komisioni i Pranimit me datën 02.06.2022 ka nxjerr vendimin me nr.02-030/01-6859/22 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër vendimit me nr.02-030/01-6859/22 KD.nr.027/2022 e datës 02.06.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Shtërpçës, me datë 29.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3787/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 01.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Shtërpçës, ndërsa me datë 20.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.580/2022 me numër të protokollit 3787/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 29.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim për përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e inspektorit të shërbimit publik i datës 06.06.2022; Njoftim për verifikimin paraprak e datës 14.04.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 20.07.2022 me numër protokollit 4206/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e letërnjoftimit ; Akt emërimi me numër Nr.Prot.02-112/03-7648/22 i datës 15.06.2022; Diploma e datës 30.10.2017; Vërtetimi mbi përvojën e punës i lëshuar nga në Prizren; Njoftimi i datës 06.06.2022 me nr.02-030/01-7310/22 mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike; Njoftimi i datës 25.05.2022 me nr.02-030/01-6600/22 për kandidatin fitues; Kopja e konkursit me nr.ptotokollit 02-111/02-1696/22 i datës 14.02.2022; Vendimi i datës 02.06.2022 me nr.02-030/01-6859/22; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 14.05.2022 Renditja përfundimtare e kandidatit fitues i datës 25.05.2020; Renditja e kandidatëve në bazë të pikëve të fituara i datës 01.06.2022 nga Komisioni i Pranimit; Konfirmimi mbi përfundimin e konkurrimit i datës 27.06.2022; Vendimi i datës 04.05.2022 me nr.02-030/01-5633/22 për formimin e Komisionit të pranimit; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 14.05.2022; Ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 01.06.2022 për Komisionin e Pranimit; Vlerësimi i punës i Personelit përkrahës; Kopja e letërnjoftimit; Letër reference; Shtojca 7 letër reference; Çertifikatë e datës 02.06.2021; Vërtetim i datës 16.11.2021 për praktik nga data 01.07.2019 - 29.12.2019; Çertifikatë e datës 31.12.2018 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina; Çertifikatë e datës 05.05.2018; Çertifikatë e datës 02.11.2021 dhe Diploma e datës 01.10.2019 nr.6528 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës"Hasan Prishtina".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me çështjen në procedurë, ka konstatuar që përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës se ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 01.03.2022 sipas njoftimit të datës 14.02.2022 me nr.02-111/01-1696/22 me nr.RN00008604 për pozitën Inspektor i shërbimeve publike në Komunën e Shtërpçës.

Me tej nga shqyrtimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me datë 29.06.2022 i është drejtuar me ankesë A.nr.580/2022 me numër protokollit 3787.2022 Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor për anulimin e procedurës

së rekrutimit të datës 14.02.2022 me nr.02-111/01-1696/22 me nr.RN00008604 për pozitën Inspektor i shërbimeve publike në Komunën e Shtërpçës.

Ndërlidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin, ka shqyrtuar dhe ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.493/2022 të datës 28.07.2021 duke obliguar Kryetarin e Komunës së Shtërpçës që të anuloi procedurën e rekrutimit për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" e shpallur sipas njoftimit të datës 14.02.2022 nga Komuna e Shtërpçës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë vlerëson se objekti i ankesës A.nr.580/2022 të datës 29.06.2022 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit A.nr.493/2022 të datës 28.07.2022 me numër protokollit 4384/2022, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, kështu që, nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike..*, Kolegji i Këshillit konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundim të procedurës administrative të filluar me ankesën A.nr.580/2022 të datës 29.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.580/2022, datë 10.08.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Shtërpçës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtërpçës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së